

## KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Kjo kontrate per shitblerje kuotash lidhet ne Tiranë, sot më 10 Dhjetor 2021, mes:

**Znj. Najada Sotir Kambo**, e lindur më 19 Nëntor 1996, në Korçë dhe banuese në Rrugën Medar Shtylla, Komuna e Parisit, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtëse e Kartës së Identitetit me numër 032647736 dhe numër personal J66119056B madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, referuar si shitësi'

**Dhe**

**Z. Rexhino Gëzim Çekrezi**, i lindur më 01.10.1993 në Belsh dhe banues në Rezidencën Rolling Hills, Villa 11, Lundër, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtës i Kartës së Identitetit me numër 034528799 dhe numër personal J31001102S madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, referuar si blerësi.

Shitesi dhe Bleresi referohen se bashku edhe si "Palet" dhe veçmas si "Pala".

**Duke qenë se** shoqëria "Trifolium" sh.p.k., është themeluar në Shqipëri më 24 Qershor 2021 dhe ka një kapital prej 100,000 leke të ndare në 4 (katër) kuota, me vlerë si vijon:

- i. Ortakja Znj. Najada Kambo zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 2,100 (Dy mijë e njëqind) Lekë që përben 2.1 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.;
- ii. Ortaku Z. Ori Hoxha zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 39,300 (Tridhjetë e nëntë mijë e treqind) Lekë që përben 39.3 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- iii. Ortaku Z. Rexhino Çekrezi zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 29,300 (Njëzet e nëntë mijë e treqind) Lekë që përben 29.3 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- iv. Ortaku Z. Admir Malaj zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 29,300 (Njëzet e nëntë mijë e treqind) Lekë që përben 29.3 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.;

**Duke qenë se** Shitesi deshiron te shese kuotën e tij, që është në masën e 2.1% te kapitalit të shoqërisë "Trifolium" sh.p.k dhe Blerësi në ekzekutim të kësaj Kontrate shpreh vullnetin të blejë këtë kuotë të shoqërisë "Trifolium" sh.p.k, sipas përcaktimeve dhe kushteve të vendosura në këtë kontratë.

**Në përputhje me sa më sipër u parashtruan**, premtimet e ndërsjella, marrëveshjet, përfaqësimet dhe garancitë e përmbajtura në këtë dokument, si edhe sipas përcaktimeve dhe kushteve të vendosura në këtë kontratë, Shitesi dhe Bleresi bien dakord si vijon:

Çdo marrëveshje paraprake e arritur mes palëve sa më sipër pranohet dhe miratohet si pjesë e dispozitave vazhduese.

### Neni 1

#### Palët e kontratës

1. Palët e kësaj kontrate janë:
  - a. Znj. Najada KAMBO, referuar ne kete kontrate si Shitës; dhe
  - b. Z. Rexhino ÇEKREZI, referuar ne kete kontrate si Blerësi;
2. Palët dhe/ose përfaqësuesit e palëve sa më sipër gëzojnë të gjitha tagrat për të përfaqësuar personin e tyre fizik në pranimin e termave të kësaj kontrate dhe nënshkrimin e saj.
3. Palët i kanë paraqitur njëra tjetrës gjithë autorizimet që legjitimojnë praninë e tyre në këtë kontratë dhe i kanë pranuar ato si të vërteta dhe të rregullta.

## Neni 2

### Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është shitblerja e një kuote në masën e 2.1% të kapitalit të shoqërisë "Trifolium" sh.p.k, të zotëruar nga ortaku Najada KAMBO. Kuota do t'i shitet z. Rexhino ÇEKREZI.

## Neni 3

### Baza ligjore

Kalimi i kuotës me kete kontrate bazohet ne nenin 73 te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret; dhe shoqerite tregtare" të ndryshuar.

## Neni 4

### Garancitë e ndërsjella

Shitësi garanton Blerësin se është pronar me të drejta të plota mbi objektin e kontratës, e zotëron të plotë dhe të lirë e pa asnjë barrë rënduese dhe se të gjitha garancitë e treguara dhe të pranuar nga Blerësi, vazhdojnë të mbeten të vlefshme deri në ekzekutimin e plotë të kësaj kontrate si dhe në çdo moment pas përbushjes së kontratës.

## Neni 5

### Vlera e kontratës

1. Shitësi ka rënë dakord t'ia shesë Blerësit objektin e kësaj kontrate, me një çmim prej 2,100 (dymijë e njëqind) Lekë dhe Blerësi ka rënë dakord t'ia blejë Shitësit përkatësisht objektin e kësaj kontrate, me këtë çmim.
2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi pranon se pagesa sa më sipër është kryer nga Blerësi dhe se Shitësi nuk ka më asnjë pretendim lidhur me kryerjen e pagesës sipas kësaj kontrate.
- 3.

## Neni 6

### Transferimi i kuotës

1. Transferimi i kuotës do të bëhet duke ekzekutuar kontratën nëpërmjet regjistrimit të transferimit në regjistrin tregtar. Regjistrimet kryhen në përputhje me afatet ligjore.
2. Palët konfirmojnë se pas ekzekutimit të kësaj kontrate dhe përfundimit të procedurave për kalimin e kuotës vetem për efekt të kësaj kontrate, ortaku Znj. Najada KAMBO nuk do të jetë ortak i shoqërisë "Trifolium" sh.p.k, ndërsa ortaku Z. Rexhino ÇEKREZI do të zotërojë 31.4% të kapitalit të shoqërisë.

## Neni 7

### Detyrime të shitësit dhe blerësit

Shitësi dhe Blerësi kanë detyrimin që të përbushin me rigorozitet kushtet e përcaktuara në këtë kontratë. Shitësi dhe Blerësi janë përgjegjës në mënyre solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave, nga çasti i kalimit të kuotave deri në regjistrimin e kalimit të tyre në regjistrin tregtar. Palët përgjigjen përkatesisht për detyrimet fiskale që mund të aplikohen për shkak të kalimit të kuotave, mbi secilin prej tyre. Shitësi është dakord që me nënshkrimin e kësaj kontrate të mos ketë më pretendime në lidhje me marrëdhënien e punës me shoqërinë ku kjo e fundit është në cilësinë e punëdhënëses.

### Neni 8

#### Mosndërhyrja në Biznes

(a) **Moskonkurrenca** – Shitësi merr përsipër se për një periudhë prej 1 (një) viti pas nënshkrimit të kësaj kontrate, nuk do të angazhohet në asnjë biznes apo aktivitet tjetër të cilat janë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, konkurrues me aktivitetet e biznesit të Shoqërisë kuotat e të cilës po shet, pa marrë pëlqimin paraprak me shkrim të saj.

(b) **Mosnxitja** - Shitësi pajtohet se për një periudhë prej 1 (një) viti pas përfundimit të kësaj kontrate, nuk do të:

- (i) shkëpusë apo përpiqet për të shkëputur nga Shoqëria kuotat e së cilës po shet ndonjë biznes të çfarëdo lloji në të cilin ajo është e angazhuar, duke përfshirë, pa kufizim, kërkesën e apo ndërhyrjen tek ndonjë nga furnitorët, klientët, apo
- (ii) të punësojë, kërkojë të punësojë, ose të rekomandojë për punësim çdo person të punësuar nga Shoqëria, për një periudhë prej një (1) viti pas kësaj.

### Neni 9


#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët angazhohen që të zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që lindin gjatë përmbushjes së kësaj kontrate. Në rast të mos zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Tiranës.

Kjo kontrate nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me vlefshmëri të njëjtë. Palët e kësaj kontrate mbajnë të paktën nga një kopje origjinale të kontratës.


**BLERËSI**

**Rexhino ÇEKREZI**

 Rexhino Çekrezi

**SHITËSI**

**Najada KAMBO**

 Najada Kambo

Banka Kombëtare Tregtare : 15-DEC-2021 13:04

TELLER CASH DEPOSIT ALBANIA  
TELLER CASH DEPOSIT ALBANIA

KLIENTI: 505004822  
EMRI I KLIENTIT: NAJADA KAMBO  
ADRESA E KLIENTIT: RR MEDAR SHTYLLA NR 7 FRA C  
AP 48 NJESIA 5  
AL/TIRANE/1020

REFERENCË : 403TCDA213490064  
DATË VALUTA/VALUE DATE : 15-DEC-21

LLOGARIA E VEPRIMIT/TXN ACC : 505004822CLIDCLALLMC  
IBAN : AL26 2051 1557 0048 22CL IDCL ALLM  
EMËRTIMI I LLOGARISË/ACC DESC : NAJADA KAMBO  
SHUMA E VEPRIMIT/TXN AMOUNT : 2,100.00 ALL  
OFS ACC : BA1112000  
EMËRTIMI I LLOGARISË/ACC DESC : BKT  
OFS AMOUNT : 2,100.00 ALL  
KURSI I KËMBIMIT/EXCH RATE : 1

NR. I CEKUT/CHEQUE NO :  
KODI I BANKËS/CLG BANK :

PËRMBLEDHJE E KOMISIONIT/CHARGE/TAX SUMMARY

SHUMA BAZE/BASE AMT : 2,100.00 ALL  
TOT TAX : 0.00 ALL  
KOMISIONI/TOT CHG : 500.00- ALL

SHUMA NETO/NET AMT : 2,600.00 ALL

BURIMI I TË ARDHURAVE :

PËRSHKRIMI I VEPRIMIT :  
REXHINO CEKREZI DERDH NE LLOG TE NAJADA KAMBO PER BLERJE AKSIONESH

KLIENTI : EMËR MBIEMËR FIRMË

*ReXHino Çekrez: R*

Unë konfirmoj me nënshkrimin e këtij mandati se të dhënat e printuara janë të sakta sipas kërkesës time. Ky mandat do të shërbejë si provë për çdo pretendim në të ardhmen.

\*\*\*\*\* Sipas Kushteve të Punës në fuqi \*\*\*\*\*

Punonjësi i degës: \_\_\_\_\_

**KB** Rr. Elbasanit  
15 -12- 2021  
H 205 / 11038

PRERJA	SASIA	VLERA
	2x7000	
	1x1000	
	2x100	